

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUŠITRI

02 Nr. / Br. 873/18
Nr. i Eq. / Br. sh. 02
Data: / Datum 04.07.2018

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI



në mes të

Komunës së Vushtrrisë dhe Demokraci Plus (D+)

Qëllimi i Memorandumit

Me qëllim të artikullimit të kërkesave të qytetarëve për përmirësim të shërbimeve publike nën përgjegjësi komunale përmes platformave elektronike, Komuna e Vushtrrisë dhe Demokraci Plus (D+) përmes këtij memorandumi shprehin vullnetin për të bashkëpunuar në pikat e mëposhtme:

1. Përdorimin e platformës elektronike ndreqe.com (nga këtu 'platforma') për të adresuar ankesat e qytetarëve të Vushtrrisë për përmirësimin e shërbimeve publike në lagjet dhe fshatrat e tyre;
2. Komunikimin konstruktiv dhe angazhimin për të zgjidhur kërkesat dhe ankesat e qytetarëve të shtruar përmes platformës;
3. Informimin e qytetarëve për statusin e veprimeve të ndërmarra pas kërkesave dhe ankesave të qytetarëve në platformë.

Përgjegjësitë e D+:

Përmes këtij memorandumi, për të arritur synimet e lartëpërmendura, D+ zotohet të:

- Mirëmbaj dhe promovoj në mënyrë të paanshme politike një platformë që do të mund të shërbej si medium për qytetarët e Vushtrrisë që të raportojnë problemet me shërbimet publike në lagjet apo fshatrat e tyre;
- Informojë në mënyrë të menjëhershme dhe të përshtatshme zyrtarët komunal për raportimet e qytetarëve në platformë;
- Raportojoj në baza mujore zyrtarët komunal për gjendjen e raportimeve dhe rregullimeve në platformë; Më tutje të ofrojë hartat digjitale të komunës së Vushtrrisë që saktësojnë çfarë kërkesa/ankesa janë raportuar dhe lokacionin e saktë në hartë digjitale;
- Lehtësoj komunikimin e komunës me qytetarët aktiv në platformë;
- Ofroj asistencë teknike për zyrtarët komunal për përdorimin e platformave elektronike.

Përgjegjësitë e Komunës së Vushtrrisë

Përmes këtij memorandumi, për të arritur synimet e lartë përmendura, Komuna e Vushtrrisë zotohet të:

- Angazhohet për trajtim të raportimeve të qytetarëve në lidhje me shërbimet publike komunale të regjistruara përmes platformës;
- Bëjë përpjekje që të zgjidh në kohë sa më të shkurtë kërkesat dhe ankesat e qytetarëve sipas mundësive kohore dhe buxhetore;
- Vë në gatishmëri resurset komunale që i kanë nën menaxhim për t'u përgjigjur kërkesave të administratorëve të platformës për gjendjen e kërkesave dhe ankesave të shtruar përmes platformës;
- Promovojë përdorimin e platformave tek drejtuesit e institucioneve komunale në mënyrë që të shërbej për ndërlidhje më të ngushtë me qytetarët aktiv të komunës.
- Të caktojë një zytar komunal si pikë kontaktuese për Demokraci Plus për realizimin e kësaj iniciative;
- Lejoj qasje të www.ndreqe.com në intranetin e komunës;

Inicialet - K. Vushtrrisë

Inicialet - D+

- Të sigurojë që zytarët komunal marrin pjesë në punëtoritë (sesione informuese mbi atë se si funksionojnë platformat) e paraparë nga Demokraci Plus.


Komuna e Vushtrrisë dhe D+ pajtohen të mbajnë raporte konstruktive të ndërsjellët gjatë këtij bashkëpunimi dhe të respektohet pavarësia dhe paanshmëria politike e D+ si organizatë jo-qeveritare.

Ky memorandum do të hyjë në veprim në mënyrë të menjëhershme dhe të jetë efektiv për një kohë të pacaktuar. Memorandumi mund të amendamentohet në çdo kohë me pëlqimin e dy palëve, dhe në mënyrë periodike do të vlerësohen arritjet.


Kryetari i Komunës
Komuna e Vushtrrisë

Përfaqësuesi
Demokraci Plus (D+)

Xhafer Tahiri




Datë:



04-07-2018

Jetmir Bakija



Datë:

04-07-2018